

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore (“Gazeta zyrtare e RM” nr.58/00 dhe 44/02) dhe neni 24 dhe 26 të ligjit për arsim të mesëm (“Gazeta zyrtare e RM” nr.44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/ 06, 70/06 dhe 51/07), ministri i arsimit dhe shkencës miratoi program mësimor në lëndën fakultative kërcime dhe valle popullore për klasën e VI të arsimit fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e VII, VIII ose IX për arsimin fillor nëntëvjeçar.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
ENTI PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

**PROGRAMI MËSIMOR**

**KËRCIME DHE VALLE POPULLORE**

LËNDË FAKULTATIVE

ARSIMI FILLOR

## **1. HYRJE**

Lënda mësimore *kërcime dhe valle popullore*, është lëndë fakultative që mund ta zgjedhin nxënësit e arsimit fillor nëntëvjeçar (në klasën të VII, të VIII ose të IX). Fondi javor i orëve të kësaj lënde është 2 orën në javë, përkatësisht 72 orë gjatë gjithë vitit shkollor.

Qëllimi i kësaj lënde fakultative është të njihen me krijimtari popullore tradicionale në Maqedoni, të mësojnë një numër të caktuar vallesh popullore dhe një numër të caktuar – kërcimesh moderne bashkëkohore. Mësimi i kësaj lënde mësimore do të nxit dashuri për traditat, kultivimi i kërcimeve bashkëkohore për shprehje personale, emocione pozitive, kreativitet, të shprehur estetike në punën individuale dhe në grup.

### **SHËNIM:**

**Në pajtim me dinamikën për futjen e edukimit dhe arsimit fillor nëntëvjeçar programi mësimor për nxënësit e klasës të VI të arsimit fillor tetëvjeçar të vitit shkollor 2008/09 është ekuivalent me programin mësimor për klasën e VII, të VIII ose të IX të arsimit fillor nëntëvjeçar.**

## **2. SYNIMET TË PROGRAMIT MËSIMOR PËR KLASËN E VII, VIII OSE TË IX**

Nxënësi/ nxënësjja:

- të përvetësoj njohuri për lojërat dhe kërcimet tradicionale, të kultivohen dhe zhvillohen aftësitë interpretuese të lëvizjeve ritmike të trupit të sinkronizuara me muzikën;
- ta përjetoj bukurinë e lojërave dhe kërcimeve tradicionale;
- të ketë interes për lojërat dhe kërcimet tradicionale;
- të nxitet shprehja e lirë në lojë dhe të çlirohet nga stresi dhe tendosja psikiko- emocionale;
- të krijoj vetëbesim në interpretim (orientim në hapësirë, sinkronizim dhe koordinim i lëvizjeve, njohja dhe ndryshmi i radhës të lëvizjeve dhe realizimi i aktivitetin të plotë psikomotorik);
- t'i respektoj aftësitë e veta interpretuese dhe aftësitë e të tjerëve;
- të nxitet të kërcej vetë, çift dhe në grup;
- të njihet me kërcimin e disa llojeve kërcimesh historike;
- të njihet me kërcimin e disa llojeve kërcimesh artistike;
- të njihet me karakteristikat kryesore të valleve popullore;
- të njihet me kërcimin e disa llojeve vallesh popullore.

### 3. SYNIME KONKRETE

<b>1. KËRCIME (10 orë)</b>			
<b>Synime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Terma</b>	<b>Aktivitete dhe metoda</b>
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <p>-Të njihet me kërcimin si lojë, lëvizje.</p> <p>-Të njihet me lloje të ndryshme kërcimesh.</p>	<p>-Kërcim</p> <p>-Pantomimë</p> <p>-Kërcim historik</p> <p>-Kërcim artistik</p>	<p>Kërcim</p> <p>-Pantomimë</p> <p>-Kërcim historik</p> <p>-Kërcim artistik</p>	<p>-Nxënësit bisedojnë, përgatisin reklamë prezantimi për lindjen e kërcimit.</p> <p>-Atelie për shprehjen e gjendjeve të ndryshme emocionale nëpërmjet pantomimës;</p> <p>-përcaktimi dhe diskutimi për termat kërcim popullor, historik dhe artistik;</p> <p>-atelie me video-regjistrime për dallimin midis kërcimit popullor dhe atij historik.</p>
<p>-Të njihet me lloje të ndryshme kërcimesh historike</p> <p>-Të njihet me lloje të ndryshme kërcimesh bashkëkohore.</p>	<p>- Lloje kërcimesh sipas evenimentit</p> <p>- Lloje kërcimesh sipas ritmit dhe metrikës</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Valcer</li> <li>- Tango</li> <li>- Menuet</li> <li>- Fokstrot</li> <li>- Suing</li> <li>- Ça-ça-ça</li> <li>- Rumba</li> <li>- Samba</li>   <li>- Rok</li> <li>- Tvist</li> </ul>	<p>-Lloje të ndryshme kërcimesh historike (fotografi, video-regjistrime);</p> <p>- reklamë prezantimi për lloje të ndryshme kërcimesh;</p> <p>-atelie për përvetësimin e një modeli kërcimi – hapa.</p> <p>-Lloje të ndryshme kërcimesh moderne (fotografi, video-regjistrime);</p> <p>- atelie për përvetësimin e një modeli kërcimi – hapa.</p>

-Të njihet me lloje të ndryshme kërcimesh artistike.	- Baleti klasik - Baleti modern	- Baleti klasik - Baleti modern	-Dëgjimi dhe ndjekja balet (klasik dhe modern); -ndjekja e një shfaqjeje baleti.
--	------------------------------------	------------------------------------	---

<b>2. KLASIFIKIMI I VALLEVE POPULLORE (10 orë)</b>			
<b>Synime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Terma</b>	<b>Aktivitete dhe metoda</b>
Nxënësi/nxënësja:  - t'i vërej dhe dalloj karakteristikat kryesore të valleve popullore ;  -t'i vërej dhe dalloj karakterin dhe përmbajtjen e valleve.	Ndarja e traditës vallekërcyese:  -Mashkullore – femërore -të ngadalta – të shpejta -forma e valleve -kuvendare –rituale - karakteristika të rajoneve të ndryshme vallekërcyese	Mashkullore – femërore -të ngadalta – të shpejta -forma e valleve -kuvendare –rituale -rajone të ndryshme vallekërcyese	Prezantim audiovizual i valleve popullore tradicionale nga thesari i pasur kulturor i Maqedonisë (nga bashkësi të ndryshme etnike).

<b>3. LOJËRA RITUALE (16 orë)</b>			
<b>Synime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Terma</b>	<b>Aktivitete dhe metoda</b>
Nxënësi/nxënësja:  - të njihet me ndarjen e valleve popullore;  -të njihet me lojërat rituale;  - t'i vërej dhe dalloj karakteristikat kryesore të lojërave rituale.	Ndarja e lojërave rituale:  -procesione mashkullore - procesione femërore - cikli dasmor	1. Procesione femërore - Vallja e shën Llazarit - Vallja e ujit - Dodola - Vallja e Varvarushave - -Vallja e shën Ivanit 2. Procesione mashkullore - Rusalë	-Hulumtim dhe mbledhja e materialeve etnografike;  -formimi i këndit muzikor;  -përgatitja e materialit reklamues;  -bashkëpunimi me institute të ngjashme;

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lojëra me paska</li> </ul> <p>3. Cikli dasmor</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vallja e vjehrrës</li> <li>- vallja e dhëndrit</li> <li>- vallja e nuses</li> <li>- vallja e nunit</li> <li>- vallja pelivane</li> <li>- mbrëmja e vajzërisë</li> <li>- martifal</li> </ul>	<p>-organizimi i shfaqjeve dhe orëve të hapura;</p> <p>-ligjërata teorike dhe praktike.</p> <p><b>Në varësi të interesit nxënësit përvetësojnë dy lojëra rituale.</b></p>
--	--	---	---

<b>RAJONE VALLEKËRCYESE (36 orë)</b>			
<b>Synime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Terma</b>	<b>Aktivitete dhe metoda</b>
<p>Nxënësi/nxënësj:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të njihet me ndarjen e valleve popullore sipas rajoneve etnografike në RM;</li> <li>-t'i vërej dhe t'i dalloj karakteristikat kryesore të valleve popullore të rajoneve të veçanta;</li> <li>-të njihet me valle të veçanta popullore të rajoneve të veçanta vallekërcyese;</li> <li>-të zhvilloj ndjenjë për vlerën artistike të valleve.</li> </ul>	<p>RAJONI VALLEKËRCYES PERËNDIMOR</p> <p>RAJONI VALLEKËRCYES JUGLINDOR</p> <p>RAJONI VALLEKËRCYES JUGOR</p> <p>RAJONI VALLEKËRCYES LINDOR</p> <p>RAJONI VALLEKËRCYES VERIOR</p>	<p>Emërtime vallesh nga rajonet vallekërcyese që janë objekt mësimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hulumtim dhe mbledhja e materialeve etnografike;</li> <li>-përgatitja e materialit reklamues;</li> <li>-organizimi i shfaqjeve dhe orëve të hapura;</li> <li>-ligjërata teorike dhe praktike;</li> <li>-mësimi (kërcimi) i një valleje nga çdo rajon vallekërcyese.</li> </ul>

#### 4. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Lënda mësimore fakultative *kërcime dhe valle popullore* jep mundësi të realizohet në mënyrë të integruar me lëndë të tjera dhe përmbajtjet të programeve të tjera mësimore: art plastik, edukatë muzikore, gjuhë amtare, histori etj., por edhe me planifikim dhe realizim të brendshëm të integruar të temave dhe aktiviteteve.

Gjatë realizimit të përmbajtjeve mësuesi duhet të krijoj klimë të mirë pune dhe vazhdimisht të krijoj motivim për punë tek nxënësit me nxitjen dhe përkrahjen e pavarësisë dhe të vetëbesimit tek çdo nxënës.

##### Fondi vjetor i orëve

	TEMA	Numri i orëve
1	Kërcime	10
2	Klasifikimi i valleve popullore	10
3	Lojëra rituale	16
4	Rajone vallekërcyes	36
	Gjithsej	72

*Shënim: Numri i orëve është dhënë në mënyrë orientuese*

- *Mjete mësimore:*
- mjete audio-vizuale (TV, DVD-pleer, videopleer, kompjuter etj.);
- udhëzues, skema, skica etj;
- mjete dhe materiale didaktike
- mjete vizuale (piktura, fotografi, aplikime etj.)
- Internet, softuerë arsimor ;



## **5 MËNYRA E NDJEKJES DHE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE**

Gjatë mësimit ndiqen dhe vlerësohen rregullisht arritjet e nxënësve, mblidhen tregues për aktivitetet e tyre, motivimi për shprehje artistike, angazhimi i nxënësve, përkushtimi në punë, bashkëpunimi me të tjerët dhe aktivitetet e tyre shprehëse, etj. (vlerësim formativ). Gjatë ndjekjes të arritjeve të nxënësve, mësuesi duhet të bëjë kujdes me qasjen individuale kundrejt çdo nxënësi nëpërmjet shprehjes të tij, punës dhe interpretimit, prezantimit, demonstrimit individual dhe mjete e proceduar të tjera për ndjekjen e me vlerësimin e përfundimtar të nxënësve në fund të vitit.

Nxënësi vlerësohet me notë.

## **6 KUSHTE E AMBIENTIT PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR**

Programi në lidhje me kushtet e ambienteve bazohet në Normativën për ambient, pajisje dhe mjete mësimore për shkollën fillore nëntëvjeçare, të miratuar nga ministri i arsimit dhe shkencës me Vendim nr. 07-1830/1 të datës 28.02.2008.

## **7 NORMATIVA PËR KUADROT MËSIMDHËNËS**

Punën edukativo-arsimorë për realizimin e programit kërcime dhe vale popullore mund ta kryej person që ka mbaruar:

- Fakultetin e artit muzikor.

## **8 REZULTATET E PRITURA**

Nxënësi / nxënësja:

- Të di t'i interpretoj si duhet kërcimet, lojërat rituale dhe vallet (sipas programit)
- Të dalloj valle nga krahina të ndryshme të Maqedonisë (nga ato që ka mësuar);
- Të zhvilloj aftësi për dëgjimin e muzikës;
- Të identifikon rritëm të caktuar;
- Të përdor terminologji përkatëse të traditës vallekërcyese;
- Të dalloj valle rituale nga ato kuvendare;
- Të demonstroj shabllone kërcimi;
- Të ketë njohuri për elementet dhe karakteristikat e krijimtarisë muzikore popullore.
- Të dalloj ndarjen në traditën vallekërcyese.

#### **9 KOMISIONI PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT MËSIMOR**

1. Veçislav Popovski, këshilltar për arsimim muzikor BZHA (koordinator) - Shkup
2. Vladimir Janevski, FAM – Shtip, Departamenti për etno-koreografi
3. Xhengiz Ibrahim, mësues, SHF “Tefejuz” – Shkup
4. Tomislav Tanevski, mësues, Qendra për fëmijë - Xhunxhule – Shkup
5. Florim Zylfiu, mësues – SHF “Diturija” – f. Likovë

#### **10 VENDIM DHE DATA E MIRATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR**

Programin mësimor *projekte nga kërcimi dhe valle popullore* për klasën e gjashtë të arsimit fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e shtatë, tetë ose të nëntë të arsimit fillor nëntëvjeçar e solli

Ministri

\_\_\_\_\_

data \_\_\_\_\_